A.K.P.A.
Nr 2837 Prot
Datë,më 26.10.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK RAJONI VERILINDOR

Nr.498/1prot Tirane me 26.10.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje vend i lirë.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",QFPPRVL, ju njofton krijimin e lëvizjes vend i lire për pozicionin :

1.Instruktor/e të praktikës profesionale per kursin,Automekanike - Rajoni Laç-1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen vend i lirë:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:
a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

2. Dokumentet e aplikimit
Dosja e aplikimit,e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të lëvizjes paralele, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi.
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera ne gjuhen shqipe dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin QFPPRVL, brenda datës ...02.11.2026

3.Vleresimi I kandidatëve do të bëhet referuar pëcaktimeve të udhëzimit nr.759,datë 27.05.2024, "Per mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë ,menaxhimin e burimeve njerëzore,përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve te arsimit dhe formimit profesional dhe i zhvillimit te vazhduar te personelit",I ndryshuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL - VERILINDOR - AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËS

Drejtori

MIHAL KALOJERI